

**Xhaklina Cani** (1989 – ). Lektore në departamentin e kimisë industriale të Fakultetit të Shkencave të Natyrës pranë Universitetit të Tiranës. Anëtare e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2017). Arsimin e mesëm e ka kryer në gjimnazin "Zihni Magani" (2007) në Peqin. Studimet *bachelor* për kimi industriale dhe mjedisore i ndoqi në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës (2010), ndërsa studimet pasuniversitare, *master i shkencave* në inxhinieri të proceseve kimike, pranë këtij universiteti në departamentin e kimisë industriale, Seksioni i Inxhinierisë Kimike (2012). Në vitin 2013 fiton të drejtën për të ndjekur studimet e ciklit të tretë në drejtimin “Proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe mbeturinave industriale urbane”, në FSHN, pranë departamentit të kimisë industriale. Në bazë të shkollës së doktoraturës ajo vazhdoi kërkimet shkencore në fushën e teknikave të modelimit dhe simulimit për karakterizimin optimal të naftës bruto të vendit tonë. Merr gradën shkencore “Doktor” me vlerësimin “shumë mirë” (31 janar 2017).

Znj. Cani ka punuar si lektore e jashtme në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, departamenti i kimisë industriale, Seksioni i Inxhinierisë Kimike, pranë Universitetit të Tiranës (2013–2015), gjithashtu ka punuar si inxhinier kimike në një kompani private (2014–2015). Në qershor të 2015 emërohet pedagoge e rregullt në Grupin e Inxhinierisë së Proceseve Kimike, të departamentit të kimisë industriale dhe mjedisore, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Aktiviteti i saj përfshin dhënien e leksioneve, seminareve dhe laboratorëve me studentët e studimeve të nivelit *bachelor* dhe *master shkencor* në 5 disiplina mësimdhënieje, si dhe aktivitetin kërkimor e shkencor, i cili përfshin botimin e 8 artikujve në revista shkencore jashtë vendit dhe brenda vendit, si dhe 15 pjesëmarrje me referime në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca), në njërin prej të cilëve ka fituar çmimin e parë për prezantimin më të mirë.